

**RAPORTI NGA VLERËSIMI I
PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE, PROCESIT TË MËSIMDHËNIES DHE
SHËRBIMEVE**

SEMESTRI DIMËROR 2023/24

Prishtinë, 2024

RAPORTI NGA VLERËSIMI I PROCESIT TË MËSIMDHËNIES DHE PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE

Me qëllim të rritjes së kualitetit të mësimdhënies së vetë mësimdhënësve dhe Kolegjit, organizohen modalitete të ndryshme për vetëvlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve është rutinë vjetore e Kolegjit, që në vete ngërthen filozofinë e gjetjes së boshllëqeve dhe deficiteve të caktuara eventuale në procesin dhe metodologjinë e mësimdhënies.

Metodologjia

Vlerësimi në fund të semestrit dimëror 2023/24 është bërë përmes dy instrumenteve vijuese:

- Pyetësi për vlerësimin e moduleve, performancës së mësimdhënësve dhe shërbimeve, i plotësuar nga studentët dhe
- Pyetësi për vetëvlerësim i plotësuar nga mësimdhënësit e semestrit dimëror 2023/24.

Përmes pyetësit të parë, studentët, pra, kanë vlerësuar tri komponente: modulën, performancën e mësimdhënësve dhe shërbimet administrative. Vlerësimi për modulën është bërë përmes 3 (tri) pyetjeve të mbyllura dhe 1 (një) e hapur (e përgjithshme). Vlerësimi për performancën e stafit akademik është bërë me 9 (nëntë) pyetje të mbyllura dhe 1 (një) të hapur ndërsa vlerësimi i shërbimeve administrative është bërë me 1 (një) pyetje të mbyllur dhe 1 (një) të hapur.

Vetëvlerësimi nga ana e mësimdhënësve është bërë për kushtet dhe mjedisin e punës si dhe një reflektim për vet punën e tyre.

Për pyetjet e mbyllura, përgjigjet janë dhënë sipas shkallës së Likertit nga 1-5: [plotësisht nuk pajtohem (1), nuk pajtohem (2), neutral (3), pajtohem (4) dhe plotësisht pajtohem (5)] ose [plotësisht i/e pakënaqur (1), i/e pakënaqur (2), neutral (3), i/e kënaqur (4) dhe plotësisht i/e kënaqur (5)]

Ndërsa te pyetja ku është kërkuar nota për mësimdhënësin, janë dhënë përgjigjet nga nota 5 (minimumi) - nota 10 (maksimumi).

Analiza e të dhënave është bërë me programin Excel përmes analizës deskriptive/përshkruese. Fillimisht janë konvertuar përgjigjet në numra dhe pastaj janë nxjerrë mesataret dhe përmes “countif” janë numëruar dhe është nxjerre përqindja e përgjigjeve.

Tabela më poshtë tregon rezultatet e arritura nga vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për secilin program/profil veç e veç, të ndara ndër gjenerata.

Tabela 1. Rezultatet nga vlerësimi i performancës së mësimdhënësve – semestri dimëror 2023/24

Pyetjet/Programet	INF	LOG O	ERG O	T-Lab	Psik.	ANP	MISS	SHM L	P. Klin.	DHC	TOT AL
	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.	S.D.
Mësimdhënësi është i përgatitur për mbajtjen e mësimit.	4.43	4.51	4.40	4.65	4.63	4.24	4.46	4.84	4.40	4.76	4.53
Mësimdhënësi ka përdorur metoda të mësimdhënies të cilat më kanë mbajtur të vëmendshëm.	4.23	4.29	4.07	4.29	4.28	3.96	4.38	4.77	4.12	4.17	4.26
Mësimdhënësi ka përfshirë aktivisht studentët në bashkëbisedim.	4.36	4.42	4.45	4.47	4.38	4.27	4.45	4.83	4.36	4.89	4.49
Mësimdhënësi e menaxhon mirë orën.	4.38	4.42	4.31	4.48	4.85	4.19	4.57	4.93	4.43	4.86	4.54
Mësimdhënësi më ka ofruar mundësi, gjatë semestrit, të vlerësohem përmes kolokviumeve, seminareve, hulumtimeve, prezantimeve, detyrave etj.	4.22	4.46	4.52	4.59	5.00	4.26	4.59	4.72	4.40	4.82	4.56
Mësimdhënësi ka qenë në dispozicion të plotë për të ofruar feedback/sqarime/konsultime.	4.42	4.47	4.26	4.60	4.68	4.43	4.49	4.77	4.53	4.97	4.56
Mësimdhënësi ka stimuluar pjesëmarrjen aktive dhe debatin kritik të studentëve.	4.27	4.31	4.29	4.38	4.33	4.21	4.56	4.88	4.32	4.89	4.45
Mësimdhënësi shpjegon mirë duke përdorur shembuj praktik.	4.43	4.48	4.39	4.52	4.58	4.13	4.48	4.90	4.39	4.94	4.52
Detyrat e dhëna nga ligjëruesi na kanë ndihmuar të kuptojmë më mirë ligjëratën	4.31	4.37	4.33	4.35	4.63	4.08	4.52	4.88	4.43	4.76	4.47
Total	4.34	4.41	4.34	4.48	4.59	4.20	4.50	4.83	4.37	4.78	4.48
Vlerësimi juaj për secilin mësimdhënësi me notë nga: (5 - 10)	9.07	9.16	9.09	9.36	9.38	8.84	9.23	9.74	9.10	9.71	9.27

Siç shihet nga tabela, në përgjithësi ka vlerësim të mirë nga studentët për performancën e staft akademik me një mesatare të lartë 4.48/5 në nëntë pyetjet e para dhe me një mesatare 9.27 nga nota maksimale 10. Vlerësimi më i lartë me notë është dhënë nga studentët e programit SHML, ndërsa vlerësimi më i ultë është dhënë nga studentët e ANP.

Tabela 3. Krahësimi i rezultateve 22/23 dhe 23/24

Programet	INF	LOG O	ERGO	T-Lab	PSIK.	ANP	MISS	Sh.La	Psik. Klin	DHC	Total
Total S.D. 2023	4.36	4.31	4.41	4.15	/	4.56	4.44	4.38	/	/	4.47
Total S.D. 2024	4.34	4.41	4.34	4.48	4.59	4.20	4.50	4.83	4.37	4.78	4.48
Nota S.D. 2023	9.16	9.05	9.21	8.92	/	9.48	9.29	9.42	/	/	9.31

Nota S.D. 2024	9.07	9.16	9.09	9.36	9.38	8.84	9.23	9.74	9.10	9.71	9.27
---------------------------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------

Siç shihet nga tabela, nuk ka dallime të mëdha mes dy vlerësimeve. Në semestrin dimëror 2023/24 ka rënie të vogël të mesatares nga vlerësimi me notë i mësimdhënësve në krahasim me semestrin veror 2022/23.

Vlerësimi i moduleve/materialet/literatura

Studentët kanë vlerësuar modulet/materialet dhe literaturën e programit me 3 (tri) pyetjet e mbyllura dhe 1 (një) të hapur. Më poshtë janë dhënë rezultatet për secilin program në 3 (tri) pyetjet e mbyllura.

Tabela 14. Rezultatet nga vlerësimi i moduleve/materialeve/literatura

Programet/Pyetjet për Modulin	Sa jeni të kënaqur me modulin/lëndën?	Syllabusi i lëndës ka ofruar informata të duhura për lëndën.	Librat/materialet mësimore ishin të dobishme, të disponueshme dhe të përshtatshme për lëndën.	Total
INF	4.14	4.37	4.22	4.24
LOGO	4.14	4.33	4.24	4.24
ERGO	3.54	4.19	3.86	3.87
T.LAB	4.22	4.47	4.27	4.32
PSIK	3.98	4.83	4.60	4.47
ANP	3.99	3.91	3.60	3.83
MISS	4.22	4.32	4.24	4.26
SHML	4.47	4.47	4.37	4.44
P. Klin.	4.22	4.60	4.23	4.35
DHC	4.32	4.64	4.82	4.59
TOTAL	4.12	4.41	4.25	4.26

Nga të dhënat më lart shihet se kënaqshmëria e studentëve për modulet dhe materialet në semestrin dimëror është mjaft e lartë në të gjitha programet. Vlerësimi më i ulët është nga studentët e ANP-së ndërsa më e lartë nga studentët e DHC-së.

Vlerësimi i shërbimeve administrative

Studentët kanë vlerësuar edhe shërbimet administrative (Dekanati, IT, SIMS, Referentët, QESH, Transporti, Financa, Marketing, Provime Elektronike), me një pyetje të mbyllur dhe një të hapur.

Tabela më poshtë tregon mesataren e vlerësimit për secilin sektor nga çdo program për semestrin dimëror 23/24.

Tabela 17. Vlerësimi i Shërbimeve Administrative –23/24

	Dekanati	IT	SIMS	Referentet	QESH	Transport	Financa	Marketing	Provimet elektronike	Total
INF 1	4.1	4.6	4.2	4.2	4.4	3.6	4.0	4.2	3.7	4.11
INF 2	3.8	4.1	3.6	3.9	3.9	3.7	3.9	4.0	4.3	3.91
INF 3	4.0	3.8	3.6	3.6	3.8	3.8	3.7	3.9	4.0	3.80
Psikologji 1	4.9	4.5	4.6	4.5	4.6	4.1	4.3	4.5	4.9	4.54
T.Lab 1	4.4	4.4	4.5	4.2	4.1	3.3	3.7	4.1	4.2	4.10
T.Lab 2	4.1	4.3	4.0	3.9	4.3	4.1	4.1	4.3	4.6	4.19
T.Lab 3	4.0	4.0	4.0	4.2	4.2	4.2	4.2	4.1	4.7	4.18
Logo 1	3.9	4.4	4.1	3.8	4.1	3.9	3.9	4.1	4.1	4.03
Logo 2	3.3	4.0	3.5	3.9	3.9	3.8	3.7	3.9	4.2	3.80
Logo 3	3.9	4.2	3.8	4.5	4.3	4.4	3.7	4.1	4.0	4.10
Ergo 1	3.9	4.7	3.7	3.8	3.3	4.3	3.1	4.3	3.0	3.79
Ergo 2	3.8	4.5	4.3	3.8	3.8	4.3	3.3	3.8	3.8	3.93
Ergo 3	3.3	3.3	3.5	3.2	3.3	3.5	3.3	3.3	4.2	3.43
ANP 1	4.0	3.9	3.7	4.0	3.9	3.9	3.9	4.0	4.0	3.92
ANP 2	3.9	4.1	3.6	3.7	3.9	3.4	3.2	3.7	4.0	3.72
MISHSH 1	3.7	3.8	3.7	3.8	4.0	3.9	3.8	3.9	3.8	3.82
MISHSH 2	4.4	4.5	4.4	4.4	4.4	3.9	4.3	4.3	4.4	4.33
SHML 1	4.0	4.0	3.5	4.0	4.0	5.0	4.0	4.0	4.0	4.06
DHC	5.0	4.7	4.8	5.0	5.0	4.3	4.8	4.8	4.8	4.80
Psikologji. K	4.4	4.3	3.7	3.7	3.8	4.2	3.9	4.0	3.8	3.98
Total	4.04	4.21	3.94	4.01	4.05	3.98	3.84	4.07	4.13	4.03

Nga tabela më lart shihet se shërbimet me të cilat studentët u ndanë më të kënaqur janë “IT” (4.21), ndërsa më pak të kënaqur janë me Financa (3.84) por ngajshëm edhe me Transport dhe SIMS.

Tabela 18. Vlerësimi i Shërbimeve Administrative – Viti Akademik 22/23 dhe semestri dimëror 23/24

Programet	Dekanati	IT	SIMS	Referentet	QESH	Transport	Financa	Marketing	Provimet elektronike	Total
Total 2023	3.64	3.96	3.56	3.69	3.90	3.70	3.58	3.76	4.06	3.76
2024 S.D.	4.04	4.21	3.94	4.01	4.05	3.98	3.84	4.07	4.13	4.03

Nga tabela më lart shihet se niveli i kënaqshmërisë së studentëve ka ngritje për secilin shërbim në krahasim me nivelin e kënaqshmërisë në vitin akademik 2022/23.

Shënim ligjor:

Ky raport është pronë e BPrAL Kolegji Heimerer dhe është përgatitur për qëllime informuese institucionale. Çdo kopjim, shpërndarje, përdorim apo interpretim i përmbajtjes së tij nga persona ose institucione të tjera, jashtë Kolegjit Heimerer, nuk lejohet pa autorizimin e shkruar të Kolegjit. Çdo keqpërdorim apo interpretim i paautorizuar i këtij raporti konsiderohet shkelje e të drejtave institucionale dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Legal Disclaimer:

This report is the property of BPrAL Heimerer College and has been prepared for institutional informational purposes. Any copying, distribution, use, or interpretation of its content by persons or institutions outside Heimerer College is not permitted without prior written authorization of the College. Any unauthorized use or interpretation of this report shall be considered a violation of the College's institutional rights and will be treated in accordance with the applicable legislation in the Republic of Kosovo.